

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

Pranuar me Priljeje: 31.03 2021		
Njesia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
1-453	17339	1



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Lipjan, 31.03.2021

THIRRJE PUBLIKE PUBLIKE PËR OJQ – të

Bazuar në Rregulloren e MF – NR-04 / 2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve :

1. Zyra e Kryetarit të Komunës së Lipjanit dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të Regjistruara në Republikën e Kosovës, (KLUBET SPORTIVE, SHOQATAT SPORTIVE) që veprimtarinë e vet e zhvillojnë në Komunën e Lipjanit të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në *Avancimin, afirmimin dhe zbulimin e talenteve të rinj në SPORT në Komunën e Lipjanit* .

Ky institucion ofron mbështetje financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve (KLUBET SPORTIVE , SHOQATAT SPORTIVE) të regjistruara dhe të cilat bëjnë gara zyrtare në Federatat përkatëse.

2. OJQ-të (KLUBET SPORTIVE) në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekte në lëmin e sportit dhe sipas shpenzimeve të pranura drejtëpërdrejt si në vijim:

- a) Pagesa e referimit për ndeshjet zyrtare
- b) Pagesa e transportit për ndeshje zyrtare
- c) Pagesa e ushqimit për ndeshje zyrtare
- d) Pagesa e regjistrimit dhe kotizimit në Federatat përkatëse
- e) Pagesa për blerje të rekuizitave sportive
- f) Pagesa deri në 30 % nga shuma e subvencionuar për paga dhe medita për lojtarë dhe staf profesional
- g) Të tjera

3. Organizatat jo-qeveritare (**KLUBET SPORTIVE , SHOQATAT SPORTIVE**) mund të aplikojnë me një projekt që kontribuojnë në *Avancimin, afirmimin dhe zbulimin e talentëve të rinj në SPORT në Komunën e Lipjanit*

4. Specifikacioni :

- Klubet e futbollit anëtarë të Super Ligës 10,000.00 € - 20,000.00 €
- Klubet e futbollit anëtarë të Ligës së Parë 5,000.00 € – 15,000.00 €
- Klubet e futbollit anëtarë të Ligave tjera 1,500.00 – 5,000.00 €
- Klubet e basketbollit anëtarë të Ligës së Parë 4,000.00 – 5,000.00 €
- Klubet e basketbollit anëtarë të Ligave tjera 1,000.00 – 2,000.00 €
- Klubet e volejbollit anëtarë të Superliges A dhe B 2,500.00 – 5,000.00 €
- Klubet e volejbollit anëtarë të Ligave tjera 1,500.00 € – 3,000.00 €
- Klubet e hendbollit anëtarë të Ligës së Parë 1,000.00 -2,500.00 €
- Klubet tjera SHAHU, ATLETIKA, GJIMNASTIKA, KARATE, BOX dhe klube tjera 501.00 – 2,500.00 €
- Klubet dhe shoqatat sportive tjera 501.00 € - 2,500.00 €

5. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 80.000,00 euro.

Mjetet do të terhiqen nga kodi Subvencione për entitete jo publike

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt është 501,00 euro, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 20.000.00 euro.

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën 20.04.2021.

6. OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti një (1) projekt në kuadër të kësaj thirrje dhe vetëm në një (1) nga fushat prioritare sipas thirrjes. Periudha e zbatimit të projektit është për 6 muaj.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të(**KLUBET SPORTIVE, SHOQATAT SPORTIVE**) që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Komunën e Lipjanit para datës së publikimit të thirrjes publike.

Klubet aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e sportit. **KLUBET SPORTIVE, SHOQATAT SPORTIVE** duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Drejtoratit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, **KLUBI, SHOQATAT SPORTIVE** duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në **KLUB, SHOQATAT SPORTIVE** dhe menaxheri i projektit nuk janë

nën hetime për vepra penale, si dhe prova se **KLUBI, SHQATAT SPORTIVE** ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare (www.komunaelipjanit-rks.org).

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen personalisht në adresën e mëposhtme:

KOMUNA E LIPJANIT

Rruga „Shqipëria”

Zyra për shërbim të qytetarëve , nr 3,

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

8. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: bekim.zaskoku@rks-gov.net

z. Imri Ahmeti

Kryetar i Komunës së Lipjanit

